



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 745/7 Prot.

Tiranë, më 14.10.2025

### V E N D I M

**Nr. 237, Datë 14.10.2025**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>, mori në shqyrtim ankesën me nr. 111 Regj., datë 07.05.2025, të shtetasve A. dhe S. M.<sup>3</sup>, kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me pretendimin për diskriminim, për shkak të: “racës, moshës, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës të shtetasve A. dhe S. M., (bashkëshortë), në mes të tjerash, parashtrohet se:

*“A. M., (49 vjeç) dhe S. M., (44 vjeç) janë të martuar dhe u përkasin komunitetit rom. Ata kanë lindur dhe banojnë në Tiranë. Asnjëri nga të dy nuk ka ndjekur shkollën, (as atë fillore) dhe për rrjedhojë nuk kanë mësuar kurrë të shkruajnë e të lexojnë. Gjatë gjithë jetës së tyre janë përballur me vështirësi për të gjetur punë dhe kanë qenë të detyruar të shfrytëzojnë çdo mundësi për të siguruar të ardhmen për mbijetesë. Aktualisht, ata janë të punësuar në një treg me rroba të përdorura, një punë kjo me kohë të pjesshme 4 orë në ditë, me një pagë e cila nuk mbulon nevojat e tyre bazë, si qiraja, ushqimi, veshmbathjet dhe shpenzimet e tjera jetësore.*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>3</sup> Përfaqësuar para KMD-së nëpërmjet Av. A. D, sipas Prokurës së Posaçme me nr. repertori 1920 dhe nr. koleksioni 642, datë 03.03.2025.2025, të Noteres M. D.

*Në këto kushte, ankuesit vendosën të aplikojnë për ndihmë ekonomike, duke qenë se plotësojnë kriteret për përfitimin e saj.*

*Me datë 03.03.2025, ata janë paraqitur pranë Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, ku ata banojnë, për të aplikuar për ndihmë ekonomike, si institucioni publik përkatës që trajton këto kërkesa.*

*Punonjësja e kësaj Njësie Administrative, iu kërkoj të dorëzonin dokumentacionin e mëposhtëm:*

- a) Çertifikatë familjare;*
- b) Vërtetim pronësie nga ASHK-ja;*
- c) Vërtetim pune.*

*Dokumenta këto, të cilat parashikohen në VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. Për të siguruar dokumentacionin sipërcituar, ishte i nevojshëm përdorimi i portalit e-Albania, por ankuesit nuk dispononin një llogari në këtë platformë dhe për shkak të mungesës së njohurive në të lexuar dhe në të shkruar, nuk ishin në gjendje as të kuptonin dhe as të përdornin platformën.*

*Pavarësisht dijenisë për këtë fakt, pranë Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, nuk iu ofrua asnjë ndihmë për të realizuar aplikimin, por u mjaftuan në dhënien e përgjigjes standarde: “Herën tjetër sillni dokumentet për të kryer aplikimin”. Vetëm përmes ndihmës së personave të tretë, ankuesit, nëpërmjet komunikimeve me e-mail me helpdesk, mund të hapnin llogarinë në e-Albania. Kjo procedurë ka marrë kohën e saj (rreth një javë) dhe duke marrë parasysh që të dy janë në pamundësi, asistimi ka qenë i nevojshëm për të aplikuar për ndihmën ekonomike, konkretisht, për të nxjerrë dokumentet e kërkuara.*

*Ankuesit janë paraqitur fillimisht pranë ASHK-së dhe kanë kërkuar vënien në dispozicion të vërtetimit të pronësisë, por u është komunikuar që ky shërbim afrohet vetëm elektronikisht, me vulë digjitale. Në datën 03.03.2025 kanë aplikuar në e-Albania për shërbimin ASHK\_I6 (Lëshim vërtetim negativ/pozitiv), por akoma dhe pse kanë kalur të gjitha afatet ligjore nuk u kthye asnjë përgjigje lidhur me këtë kërkesë.*

*Koha e humbur nga vajtje-ardhjet nëpër sportele pa u ndihmuar për shkak të mungesës së mbështetjes institucionale dhe vështirësive në aksesimin e dokumentacionit të kërkuar, bëri që ankuesit të mos përfundonin procedurën në kohën e duhur. Kjo vonesë çoi në humbjen e mundësisë për të aplikuar për ndihmë ekonomike në muajin mars 2025.*

*Subjekti ankues ka kërkuar, ndër të tjera, nga Komisioneri:*

*Konstatimin e diskriminimit të ankuesve, nga Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, për shkak të racës, moshës, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale. Detyrimin e Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë që të marrë masa për të siguruar mjetet dhe mënyrën e ofrimit të*

asistencës dhe ndihmës për të gjithë personat, të cilët nuk mund të marrin vetë dhe në mënyrë të pavarur shërbimet on-line nëpërmjet e-Albania.”

## **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a, të LMD, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të LMD parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 745/1 prot., datë 09.05.2025, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Drejtoria Vendore, Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tirana Jug dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për ankesën e bërë nga pala ankuese, duke kërkuar në mënyrë të veçantë informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:
  - Argumentimin tuaj, lidhur me pretendimet e subjekteve ankues.
  - A janë evidentuar nga ana juaj, problematika të ngjashme, lidhur me vështirësi të hasura nga personat kërkuës/aplikues, për të marrë shërbimet on-line për shkaqet e pretenduara nga ankuesit apo mungesës së një pajisjeje elektronike të përshtatshme apo mungesës së aftësive digjitale. Nëse po, argumentimin tuaj, si dhe rastet e cituara respektivisht.
  - Në përgjigje të kësaj problematike, lidhur me ofrimin e shërbimeve on-line, a ka vënë në dispozicion institucioni juaj, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, një apo disa punonjës të cilët ndihmojnë çdo qytetar, i cili për arsye të ndryshme ka vështirësi për të siguruar në mënyrë të pavarur shërbimet online? Shpjegimet dhe argumentimin tuaj lidhur me sa mësipër, si dhe dokumentacion provues, nëse dispononi të tillë.
  - Informacion nëse, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës por dhe nga Drejtoria Vendore, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug, është ndërmarrë deri aktualisht, apo do të ndërmerren (*pas marrjes dijeni përmes kësaj shkrese të KMD-së*) masa konkrete lidhur me adresimin e zgjidhjen e kësaj problematike.
  - A është e rregulluar në aktet e brendshme të institucionit mënyra e ofrimit të asistencës për kategoritë e qytetarëve të cilët, për shkak të kushteve të tyre, nuk mund të marrin shërbimet *online* nëpërmjet *e-allbania*?
  - Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr. 3707/1 prot., datë 22.05.2025<sup>4</sup> ASHKDV Tirana Jug ktheu përgjigje duke informuar Komisionerin se:

*Në vijim të shkresës tuaj nr. 745/1 prot., datë 09.05.2025, protokolluar pranë drejtorisë tonë nr. 3707 prot., datë 12.05.2025, me anë të së cilës kërkonti informacion për pajisje me vërtetim pronësie nëpërmjet aplikimit nr. 10358, datë 03.03.2025, në emër të A. R. M., Drejtoria Vendore Tirana Jug ju bën me dije se:*

---

<sup>4</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 745/2 prot., datë 26.05.2025.

*Nga verifikimi në sistemin multifunksional rezulton se me aplikimin nr. 10358, datë 03.03.2025, ka aplikuar shtetasi A. M., me kodin e shërbimit: 16 (lëshim vërtetimesh negativ/pozitiv), ku nga ana e zyrës jeni informuar nëpërmjet sistemit elektronik në lidhje me aplikimin e sipërcituar.*

*Të gjitha veprimet administrative që ASHK bën janë shërbime kadastrale sipas nenit 63 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”. Mënyra dhe procedura si realizohen këto shërbime parashikohen në nenin e mësipërm, si dhe në VKM-në nr. 389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale” të ndryshuar.*

*Ju duhet të paraqisni në rrugë dixhitale (online) aplikimin nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, dhe pasi të shlyeni tarifën, do të pajiseni me shërbimin e kërkuar.*

*Në funksion të trajtimit të rastit dhe verifikimit të detajuar, bashkëlidhur ju dërgojmë aplikimin nr. 10358, datë 03.03.2025, në emër të A. M.*

*Gjithashtu në përgjigje të kërkesës së Komisionerit 7108/2 prot., datë 29.05.2025<sup>5</sup>, ASHK ktheu përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 9189/2 prot., datë 02.08.2023, duke informuar Komisionerin se: Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 745/1 prot., datë 09.05.2024, nëpërmjet së cilës keni kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me ankesën e av. Ana Duraku, përfaqësuese me prokurë e subjekteve A. dhe S. M., e cila pretendon se nga ana e DV ASHK Tiranë Jug nuk është vendosur në dispozicion dokumenti i kërkuar me aplikimin nr. 10358, datë 03.03.2025, ju informojmë si vijon:*

*Nga verifikimi i sistemit multifunksional evidentohet se z. A. M., ka aplikuar kërkesën me nr. 10358, datë 03.03.2025, për shërbimin nr. 52 (kodi i shërbimit 16), “Lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv)”, pranë DV ASHK Tiranë Jug. Ankuesja pretendon se nuk është ofruar ky shërbim nga institucioni i Kadastrës, por nga sistemi elektronik figuron se dokumenti për aplikimin e kryer është dërguar në adresën elektronike të subjektit A. M., në datën 04.03.2025, pra të nesërmen e aplikimit.*

*Theksojmë se Drejtoritë Vendore të ASHK ofrojnë shërbime vetëm përkundrejt aplikimeve online dhe pagesës së tarifave përkatëse të shërbimeve, por për të ndihmuar çdo qytetar i cili mund të ketë probleme në lidhje me veprimet e këtij institucioni, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK, çdo ditë specialistët e kësaj Drejtorie ofrojnë ndihmë dhe orientim në lidhje me paqartësitë e subjekteve të ndryshëm.*

*Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentin e dërguar nga DV ASHK Tiranë Jug, për aplikimin nr. 10358, datë 03.03.2025, kryer nga subjekti A. M.*

---

<sup>5</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 745/3 prot., datë 92.06.2025.

Me shkresën nr. 745/5 prot., datë 16.06.2025, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, palës ankuese (përfaqësuesit të saj ligjor), iu është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni i dërguar me shkresat nr. 3701/1 prot., datë 22.05.2025, të Drejtorisë Vendore Tirana Jug dhe nr. 7108/2 prot., datë 29.05.2025, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim paraqitjen e kundërshtimeve përkatëse.

Pavarësisht kërkesës së Komisionerit, të përcjellë me shkresën nr. 745/5 prot., datë 16.06.2025, nga ana e palës ankuese nuk është paraqitur asnjë parashtrim pranë institucionit. Sipas Fletës së Lajmërim-Marrjes nr. RR781147691AA, të lëshuar nga Zyra Postare, rezulton se pala ankuese e ka marrë këtë shkresë që në datën 16.06.2025. Megjithatë, deri në momentin e hartimit të këtij akti, nuk është dorëzuar asnjë reagim apo dokument nga ana e saj.

Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 745/6 prot., datë 01.07.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore në datën 01.07.2025.

Palëve iu është bërë e ditur, se gjatë seancës kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësojnë se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve e rrethanave të çështjes.

Seanca dëgjimore nuk u zhvillua më datë 15.07.2025, për shkak të mungesës së subjekteve ankues dhe palës kundër së cilës është bërë ankesa, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Kjo ndodhi edhe pse, sipas informacionit të zyrës postare, të dyja palët e kanë marrë njoftimin për seancën.

## **II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, si dhe në analizë të legjislacionit poshtëcitur, Komisioneri vlerëson se:

Në bazë të ligjit nr.111/2018 *“Për Kadastrën”* i ndryshuar, ASHK është institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimit publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Neni 63 *“Tarifat e shërbimit kadastra”* ka parashikuar se: *1. Çdo shërbim kadastral që ofrohet, me përjashtim të rasteve të veçanta, të parashikuara në këtë ligj, tarifohet. 2. Lista e shërbimeve kadastrale dhe tarifat për çdo shërbim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Për çdo shërbim të përjashtuar nga tarifa, Këshilli i Ministrave vendos për kompensimin e tarifës nga fondet e buxhetit të shtetit.*

Me Vendimin Nr. 389, datë 13.5.2020 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale*”, i ndryshuar (në vijim VKM Nr.389/2020), janë përcaktuar shërbimet publike kadastrale që ofron Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të ligjit nr.111/2018, “*Për kadastrën*”, mënyra e aplikimit dhe tarifat standarde për çdo shërbim. Në pikën 6, të VKM Nr. 389/2020, përcaktohet se: “*6. Të gjitha subjektet e interesuara, duke përfshirë edhe institucionet publike, e paraqesin kërkesën për shërbime kadastrale në rrugë digjitale-on-line, nëpërmjet platformës e-Albania. Tarifa e shërbimit paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për shërbim nga subjekti i interesuar ose në momentin e dhënies së pëlqimit për përfitimin e shërbimit nëpërmjet noterit.*”

Me qëllim ofrimit të shërbimeve kadastrale në rrugë digjitale *on-line*, nëpërmjet platformës *e-albania*, pranë strukturave vendore të ASHK-së, kanë funksionuar zyrtarisht Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (Adisa), të cilat nëpërmjet sporteleve fizike pritëse kanë asistuar qytetarët në kryerjen e shërbimeve kadastrale.

Sipas nenit 61, të ligjit nr.107/2021 “*Për bashkëqeverisjen*” parashikohet: “*1. Ofrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet shërbimofruese, aplikimet e të cilave realizohen nëpërmjet platformës “e-Albania” do të realizohet vetëm elektronikisht, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik.....*”

Në bazë të dispozitës së mësipërme ligjore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 252, datë 29.4.2022 “*Për procedurat e ofritit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofritit të tyre*”, i cili përcakton në mënyrë të detajuar ofrimin e shërbimeve *on-line*. Në fushën e veprimtimit të këtij vendimi përfshihen shërbimet e të gjitha institucioneve shërbimofruese, aplikimet e të cilave kryhen nëpërmjet platformës “*e-Albania*” dhe që duhet të realizohen vetëm elektronikisht, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik. Ky vendim ka për objekt rregullimin e: a) procedurës së ofritit të shërbimit në mënyrë elektronike nga institucionet shtetërore, duke lëshuar dokumentin përfundimtar elektronik, me nënshkrim ose vulë elektronike, në favor të subjektit kërkuar; b) procedurës dhe të afateve të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në marrjen e shërbimit dhe të dokumentit elektronik me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik; c) metodologjisë së monitorimit dhe të kontrollit të veprimtarisë administrative, që kryhet në funksion të ofritit të shërbimit në mënyrë elektronike.

Nëpërmjet VKM Nr. 252/2022 “*Për procedurat e ofritit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofritit të tyre*”, është vendosur mbyllja e sporteleve fizike nëpërmjet të cilave bëhej ofrimi i shërbimeve të ndryshme publike, përfshi edhe shërbimet kadastrale, si dhe sportelet fizike të Adisa-

Në bazë të këtij vendimi, që prej datës 01.05.2022, janë mbyllur sportelet fizike në institucionet shtetërore dhe ofrimi i shërbimeve publike për qytetarët bëhet vetëm *on-line* nëpërmjet platformës *e-albania*. Pas mbylljes së sporteleve fizike edhe Adisa e ofron asistencën e saj vetëm nëpërmjet numrit pa pagesë 0800 0118 ose në *Chatin* në faqen: [www.adisa.gov.al](http://www.adisa.gov.al).

Nga aktet e depozituara dhe pohimet e palëve në këtë proces, rezulton se:

Me datë 03.03.2025, subjektet ankues (A. dhe S. M.) janë paraqitur pranë Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, ku ata banojnë, për të aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nga ana e punonjësës së kësaj Njësie, u është kërkuar të dorëzonin dokumentacionin respektiv, sipas kritereve e kërkesave që parashikohen në VKM nr. 597, datë 04.09.2019 *“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”*, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, evidentohet se, pengesa reale që ka pamundësuar efektivisht aplikimin e shtetasve A. dhe S. M., për fazën fillestare lidhur me përfitimin e ndihmës ekonomike, ka qenë mosparaqitja e dokumentacionit të nevojshëm, për të cilin dhe janë sqaruar.

Për të plotësuar kërkesat përkatëse, ishte e nevojshme dorëzimi i dokumentacionit siç përcaktohet në VKM nr. 597, datë 04.09.2019, përfshirë certifikatën familjare, vërtetimin e pronësisë dhe vërtetimin e punës. Për nxjerrjen e këtyre dokumenteve, aplikantët duhej të përdornin platformën elektronike e-Albania. Duke qenë se zotërinjtë M., nuk posedojnë aftësi leximi e shkrimi dhe nuk kishin llogari në këtë platformë, ata nuk kanë marrë mbështetjen e nevojshme institucionale nga Njësia Administrative Nr. 5, ku u paraqitën, por u këshilluan të sillnin dokumentat vetë, pa asnjë asistencë.

Gjithashtu, referuar pretendimeve të përfaqësuesja ligjore të subjekteve ankues, ka pohuar para KMD-së, se: *“Për të siguruar dokumentacionin sipërcituar, ishte i nevojshëm përdorimi i portalit e-Albania, por ankuesit nuk dispononin një llogari në këtë platformë dhe për shkak të mungesës së njohurive në të lexuar dhe në të shkruar, nuk ishin në gjendje as të kuptonin dhe as të përdornin platformën.*

*Vetëm përmes ndihmës së personave të tretë, ankuesit, nëpërmjet komunikimeve me e-mail me helpdesk, mund të hapnin llogarinë në e-Albania. Kjo procedurë ka marrë kohën e saj (rreth një javë) dhe duke marrë parasysh që të dy janë në pamundësi, asistimi ka qenë i nevojshëm për të aplikuar për ndihmën ekonomike, konkretisht, për të nxjerrë dokumentet e kërkuara. Ky hap ka qenë i detyrueshëm për të nxjerrë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar për ndihme ekonomike, konkretisht, për të nxjerrë certifikatën familjare, vërtetim page, vërtetimin për pronësi dhe vërtetim negativ pensioni për ankuesit.*

*Në datën 3 mars 2025 është kryer aplikimi për vërtetim pronësie online, ku pagesa e shërbimit është kryer me postë dhe fatura është bashkëngjitur në platformë. Që prej kësaj date e deri më sot*

*ky shërbim nuk është marrë nga ankuesit, pa pasur ndonjë arsye të argumentuar. Koha e humbur nga vajtje-ardhjet nëpër sportele pa u ndihmuar për shkak të mungesës së mbështetjes institucionale dhe vështirësive në aksesimin e dokumentacionit të kërkuar, bëri që ankuesit të mos përfundonin procedurën në kohën e duhur. Kjo vonesë çoi në humbjen e mundësisë për të aplikuar për ndihmë ekonomike në muajin mars 2025.”*

Sa më sipër, së pari, pala ankuese pretendon se është përballur me vështirësi të mëdha për të hapur një llogari në portalin e-Albania, për shkak të mungesës së aftësive për të lexuar dhe shkruar, si dhe mungesës së njohurive teknologjike. Si rrjedhojë, u detyruan të kërkonin ndihmën e personave të tretë dhe të komunikonin me helpdesk-un e e-Albania për të hapur një llogari dhe për të nxjerrë dokumentacionin e kërkuar, proces i cili u shoqërua me vonesa të konsiderueshme.

Së dyti, pas hapjes së llogarisë në portalin e-Albania, ata pretendojnë se atyre nuk iu ofrua asnjë formë asistence nga ana e ASHK-së, për të realizuar aplikimin. Gjatë paraqitjes së tyre pranë sporteleve të ASHK-së, u informuan se shërbimi ofrohej vetëm në mënyrë elektronike. Pasi arritën të kryenin aplikimin më datë 03.03.2025 përmes shërbimit elektronik ASHK\_16 në platformën e-Albania, lidhur me marrjen e vërtetimit të pronësisë, pala ankuese pretendon se nuk mori asnjë përgjigje nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, pavarësisht se kishin kaluar të gjitha afatet ligjore.

Ndërkohë, referuar përgjigjes së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), dërguar me shkresën nr. 9189/2 prot., datë 02.08.2025, dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se nga verifikimi në sistemin multifunksional të këtij institucioni evidentohet se shtetasi A. M., ka kryer aplikimin me nr. 10358, datë 03.03.2025, për shërbimin nr. 52 (me kod 16), “*Lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv)*”, pranë Drejtorisë Vendore ASHK Tiranë Jug.

Ndryshe nga sa pretendohet nga pala ankuese, nga të dhënat në sistem rezulton se dokumenti i kërkuar i është dërguar subjektit A. M., në adresën e tij elektronike më datë 04.03.2025, pra një ditë pas aplikimit. Ky afat i përpunimit dhe dorëzimit të shërbimit përputhet plotësisht me afatin ligjor të parashikuar për ofrimin e këtij shërbimi nga institucioni.

Pretendimi i palës ankuese se humbja e mundësisë për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike për muajin mars 2025 lidhet me pamundësinë për të aksesuar portalin e-Albania dhe për të marrë dokumentacionin përkatës, konkretisht vërtetimin e pronësisë të gjeneruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) nuk qëndron. Ky pretendim është rrëzuar në mënyrë të qartë nga verifikimet e kryera dhe dokumentacioni zyrtar i administruar nga ASHK, ku rezulton se aplikimi për shërbimin është kryer më datë 03.03.2025 dhe përgjigja është dhënë në kohë, më datë 04.03.2025, pra brenda afatit të përcaktuar ligjërisht. Si rrjedhojë, nuk provohet asnjë vonesë apo pengesë nga ana e ASHK-së që të ketë ndikuar në pamundësinë e aplikimit për ndihmë ekonomike nga subjektet ankuese.

Gjatë vitit 2022, Komisioneri ka shqyrtur problematika të ngjashme në lidhje me ofrimin e shërbimeve on-line nëpërmjet platformës e-Albania. Bazuar në informacionin e administruar nga Komisioneri gjatë ushtrimit të kompetencave për shqyrtimin e ankesave<sup>6</sup> rezultoi se, me shkresën nr. 3002/1 prot., datë 22.06.2022, Kryeministria ka informuar në lidhje me zbatimin e VKM Nr. 252/2022 dhe problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të këtij akti, duke parashtruar ndër të tjera se: *“Gjatë inspektimeve të kryera në muajin maj 2022, u konstatuan disa problematika të natyrave të ndryshme, të cilat u adresuan menjëherë nga institucioni përgjegjës, sipas rastit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), institucioni qendror përkatës, institucioni i varësisë, institucioni i vetëqeverisjes vendore. Ndër problematikat e evidentuara përfshihen edhe ato të vështirësive të disa qytetarëve për të marrë shërbimet on-line për shkak të moshës dhe/apo mungesës së pajisjeve elektronik të përshtatshme. Në përgjigje të kësaj problematike, çdo institucion përgjegjës për ofrimin e shërbimeve on-line ka vënë në dispozicion një apo disa punonjës të cilët ndihmojnë çdo qytetar, i cili për arsye të ndryshme ka vështirësi për të siguruar në mënyrë të pavarur shërbimet on-line”.*

Bazuar në të gjithë informacionin e mësipërm dhe dokumentacionin përkatës, evidentohet qartë se problematika e aksesimit të shërbimeve publike nëpërmjet platformës elektronike e-Albania nuk është një rast i izoluar, por një çështje strukturore që prek një pjesë të konsiderueshme të qytetarëve, sidomos ata që për shkak të moshës, mungesës së aftësive në të lexuar dhe në të shkruar, ose mungesës së njohurive teknologjike, nuk janë në gjendje të përdorin në mënyrë të pavarur këtë platformë. Ky shqetësim është adresuar më herët edhe nga vetë institucionet shtetërore, përfshirë Kryeministrinë, në komunikimet e tyre zyrtare, ku është theksuar nevoja për vendosjen e stafit ndihmës në institucionet përkatëse për të asistuar qytetarët në përdorimin e shërbimeve online. Në këtë kuadër, dhe duke qenë se vështirësia në aksesimin e platformës elektronike dhe në marrjen e dokumentacionit të nevojshëm nuk është e lidhur vetëm me institucionin e ASHK-së, por është një çështje ndërinstitucionale, rezultoi e domosdoshme që edhe ky institucion, sikurse të gjitha institucionet e tjera që ofrojnë shërbime publike përmes platformës e-Albania, të marrë masa konkrete për vendosjen e një strukture ose stafi ndihmës që të garantojë akses të barabartë dhe efektiv për të gjithë qytetarët, në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe të barazisë në trajtim.

Referuar përgjigjes së kthyer nga ASHK, sipas shkresës nr. 9189/2 prot., datë 02.08.2023, në lidhje me aplikimin për shërbimet që ofron Agjencia Shtetërore e Kadastrës përmes platformës elektronike e-Albania, saktësohet se pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK funksionon një strukturë e dedikuar për pritjen e qytetarëve dhe ofrimin e asistencës në rastet kur ata hasin vështirësi apo paqartësi gjatë procesit të aplikimit dhe marrjes së shërbimeve. Kjo strukturë ofron ndihmë dhe orientim për qytetarët, duke synuar të garantojë akses të barabartë dhe mbështetje konkrete në zgjidhjen e problematikave që lidhen me përdorimin e shërbimeve online, procesin e njohimit apo vonesat në komunikim. Përmes kësaj ndihme, ASHK synon të përmirësojë

---

<sup>6</sup> Ankesa Nr.77, datë 12.05.2022, paraqitur nga R.G kundër Këshillit të Ministrave.

ndërveprimin me publikun dhe të sigurojë transparencë e efektivitet në ofrimin e shërbimeve publike.

Ndërkohë që, Drejtoritë vendore të ASHK-së nuk ofrojnë më shërbime në sportele fizike, pasi aplikimi dhe marrja e shërbimeve kadastrale kryhen vetëm në mënyrë elektronike, përmes platformës e-Albania. Të gjitha kërkesat për shërbime dorëzohen online, dhe dokumentet përkatëse merren në po të njëjtën formë, të pajisura me vulë ose nënshkrim elektronik. Qytetarët që kanë nevojë për ndihmë mund të marrin asistencë vetëm përmes kanaleve zyrtare të ofruara nga ASHK dhe ADISA, si numrat pa pagesë apo komunikimi nëpërmjet faqes zyrtare.

Si perfundim, referuar dokumentacionit të administruar dhe verifikimeve të kryera në sistemin elektronik të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), rezulton se ky institucion ka përmbushur plotësisht detyrimet e tij ligjore lidhur me kërkesën e ankuesve A. dhe S. M., për lëshimin e vërtetimit të pronësisë, në përputhje të plotë me afatet dhe procedurat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Si i tillë, nga ana e ASHK-së është vepruar në mënyrë të rregullt, në kohë dhe në respektim të kuadrit ligjor përkatës, pa e penguar ose privuar palën ankuese nga marrja e shërbimit dhe ushtrimi i të drejtave të saj.

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjektet ankues, nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e ASHK-së.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e ASHK-së, ardhur për shkaqet e pretenduara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të "*racës, moshës, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale*", të shtetasve A. dhe S. M., lidhur me fazën fillestare të aplikimit për përfimimin e ndihmës ekonomike, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
2. Rekomandohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimive, të marrë masat e mëposhtme:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të marrë masa, që nëpërmjet strukturave të saj në nivel vendor, të asistojë qytetarët duke i vendosur në dispozicion një punonjës për t'i ndihmuar në marrjen e shërbimit kadastral *on-line* nëpërmjet *e-Albania*.
  - Agjencia Shtetërore e Kadastrës, duhet të marrë masa për të siguruar mjetet dhe mënyrën e ofrimit të asistencës dhe ndihmës për të gjithë personat, të cilët nuk mund të marrin vetë dhe në mënyrë të pavarur shërbimet kadastrale *on-line* nëpërmjet *e-Albania*.
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**